

Departamenti i Prokurimit

Prishtine datë, 24.08.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 23.08.2021 të parashtruar nga Grupi i Operatori Ekonomik “Labinot Vata&Partners”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Shërbime të veçanta kontraktuese për përfaqësim ligjor për nevojat e Komunës së Prishtinës”, me Nr. të Prok: 616 21 3575 211 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik “Labinot Vata&Partners”, e datës 23.08.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Shërbime të veçanta kontraktuese për përfaqësim ligjor për nevojat e Komunës së Prishtinës”, me Nr. të Prok: 616 21 3575 211 “ kundër Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, të datës 17.08.2021 .
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj aktivitetin e prokurimit*;
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Grupi i Operatori Ekonomik “Labinot Vata&Partners”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Shërbime të veçanta kontraktuese për përfaqësim ligjor për nevojat e Komunës së Prishtinës”, me Nr. të Prok: 616 21 3575 211, me datë 13.08.2021, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim.

Autoriteti Kontraktues, me datë 24.08.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë dhe ka konstatuar si vijon :


- Pretendimi për kohën e hapjes së ofertave dhe dorëzimin e tenderit nga tenderuesi i propozuar për dhënje të kontratës janë të pa bazuara dhe me të dhëna të pa sakta, pasi që publikimi i Njoftimit për kontratë është bërë me datën 10.06.2021 në orën 00:00 e jo me datë 08.05 2021 në orën 08:00 dhe poashtu është e pa saktë se tenderuesi tjetër ka ngarkuar ofertën në orën 08:30, por në orën 10:10 minuta që d.t.th.dhjetë orë e tridhjetë minuta pas publikimit;
- Pretendimi tjetër lidhur se tenderuesi i propozuar për kontratë ka dokument të vjetër nga Gjykata ju sqaroj se të njëjti i është kërkuar gjatë fazës së vlerësimit që të sjell çertifikatë valide dhe të njëjten e ka sjell (çertifikata e datës 11.08.2021);
- Pretendimi lidhur me referencat dhe listën e kontratave poashtu është i pa bazuar, pasi që pa marrë parasysh çka shkruan në dosjen e tenderit, kërkitimi i informacioneve shtesë është i rregulluar me nenin 72 të LPP-së dhe nenin 39.8 të RRUOPP-së, citati:
Lista e kontratave të realizuara nuk është dorëzuar por janë dorëzuar dëshmitë (referenca/certifikata e pranimit/kontrata) -Mund të kërkohej informata sqaruese.
Poashtu ju sqarohet se pretendimi lidhur me referencën e OE-ik "Inter Adria" është e pa bazuar, pasi që sipas dispozitave ligjore për të qenë e pranueshme një referencë merret për bazë data e përfundimit e jo e fillimit të kryerjes së shërbimeve dhe nuk ka rëndësi data e lëshimit. Poashtu është i pa saktë krahasimi që keni bërë lidhur me kinse eliminimin e tenderuesit "Sejdiu&Çerkini" pasi që tenderi i tij është trajtuar si tender i përgjegjshëm;
- Pretendimi tjetër lidhur me se tenderuesi i propozuar për dhënje të kontratës nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme për avokatët e licencuar, poashtu është i pa bazuar pasi që i njëjti ka dorëzuar dëshmi për pesë avokat të licencuar dhe Vendimi e Odës së Avokatëve për Shoqërinë e Avokatëve; dhe
- Poashtu pretendimi për kinse çmimin tuaj më të ulët pa TVSH është i pa qëndrueshëm, pasi që Autoriteti Kontraktues ka analizuar në hollësi të dy ofertat financiare dhe që të dyjat kanë çmime të njëjta në të gjitha pozicionet, ndërsa çmimi që është vendosur si më i ulët pa TVSH në tenderin tuaj sikur të merrej i saktë do të rezultonte se ju keni çmime nën pragun e lejuar të zbritjes prej 50%.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Shtojcë: Çertifikata e datës 11.08.2021.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRIŠTINA

DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE EKONOMIKE
DEPARTMAN ZA EKONOMSKA PITANJA



Agj.nr. 6077/21

Me datë –Datuma 11.08.2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti për Çështje Ekonomike, në bazë të OSNOVNI SUD U PRIŠTINI-Departman za privredna pitanja, na osnovu zahteva stranke, u smislu kërkesës së palës, në kuptim të nenit 12 paragrafi 2.10 i Rregullores për Organizimin e Brendshëm çlana 12, stav 2.10 Pravidnika o unutrašnjoj organizaciji të Gjykatave e datës 4.1.2013, lëshon këtë:
Sudova izdaje sledeće:

ÇERTIFIKATË

UVERENJE

Në regjistrat e Departamentit për Çështje Ekonomike të Gjykatës Themelore në Prishtinë,
U regjistrua Departmana za privredna pitanja Osnovnog suda u Prištini
Nuk ka - evidencë se operatori ekonomik **Avokatura Istrefi Sh.P.K. Prishtinë**, me numër biznesi **810089236**.

nema dokaza da je ekonomski operater

Nuk është - shpallur i falimentuar ose insolvent gjatë dy viteve të kaluara, dhe ndaj të njëjtit
Nije proglašen pod stečaj ili nelikvidan u protekle dve godine, i protiv istog

nuk është - e iniciuar procedura e falimentimit përkatësisht e likuidimit:
nije – pokrenut postupak stečaja odnosno raspuštanja /likvidacije/.

Kjo Çertifikatë lëshohet në kuptim të nenit 65 paragrafi 4 nënparagrafi 4.1 dhe 4.2 i Ligjit
Uverenje izdaje se na osnovu člana 65 stav 4 podstav 4.1 i 4.2 Zakona
Nr.04/L-042 për Prokurorimin Publik në Republikën e Kosovës.
br.04/L-042 o Javnoj Nabavci Republike Kosova.

E njëjta është kërkuar nga pala me qëllim të pjesmarrjes në **Tender**.
Ista je tražena od stranke, sa ciljem učesća u tenderu

dhe nuk mund të përdoret për qëllime tjera.
i ne može se upotrebiti za druge svrhe.

Taksa është paguar sipas Tarifës për taksa gjyqësore në shumë prej **5 €**, e paraparë me nenin 12.17
Taksa je plaćena po Tarifi za sudske takse u iznosu od 5 €, predviđeno članom 12.17

të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së, nr. 1/2017, në fuqi nga data 1.5.2017.
Administrativnog Upustva SSK-a, br. 1/2017, na snazi od dana 1.5.2017god.

